




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.1, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 28/2008, ftesën e datës 18.05.2022, nga Bashkia e Tiranës njësia Administrative Krrabë nenit 36. paragrafi 36.2 shkronja d), të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/49, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më datën 29.07.2022, merr këtë:

V E N D I M

Për Vizitë në Shqipëri, shkëmbim provojave dhe thellim i mëtejshëm i bashkëpunimit në nivel Lokal në mes të dy komunave, Bashkia e Tiranës njësia Administrative Krrabë dhe komuna e Vitisë

Neni 1

Me këtë vendim, Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për vizitë në Shqipëri, shkëmbim provojave dhe thellim i mëtejshëm i bashkëpunimit në nivel Lokal në mes të dy komunave, Bashkia e Tiranës njësia Administrative Krrabë dhe komuna e Vitisë vizita do të jetë tri ditore.

Neni 2

Mjete për këtë vizitë sigurohen nga buxheti i komunës së Vitisë programi buxhetor i kuvendit komunal, kategoria ekonomike, shërbime dhe mallra.

Neni 3

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është ftesa e datës 18.05.2022, nga Bashkia e Tiranës njësia Administrative Krrabë

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë

Neni 5

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 8 lidhur me nenin 9 të Rregullores Nr.10/2019 shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Shërbimit të Kuvendit;
2. MAPL-së; dhe
3. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË
K R Y E S U E S I

Bekim Azizi

